



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHITIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-24961/20 datë: 11.12.2020



Npi – 01/318 datë: 18.12.2020

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 18.12.2020 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -XI- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 18.12.2020 (e premte) në ora 10.00 h. në sallën Nr.1 të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja znj.Medina Brahaj, pastaj anëtarët e Komitetit z.Perparim Ramusa, znj.Arbresha Sylja, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari, dhe znj.Adalina Beqaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Zyrtarja Kryesore Financiare, znj.Kimete Ukaj. Mbledhjen e hapi, Kryesuesja e KPF-së znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2021,
2. Draft-Kodi Etik i Komunës së Shitimes,
3. Draft-Plani Lokal i Veprimit për Mjedis 2021-2025 për komunën e Shitimes,
4. Propozim-Ndryshimet në Rregulloren e Punës së Kuvendit, Npi-01/114 dt.26.04.2019,
5. Draft-Plani i Punës së Kuvendit për Vitin 2021,
6. Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të Kuvendit dhe KPF-së për 2021,
7. Formimi i tri Komisioneve Vlerësuese për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapi diskutimin për rendin e ditës,

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitet aprovoi rendin e ditës.**

Pika 1

Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2021

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare; Lidhur me këtë pike, znj Kimete Ukaj, ka dhënë fillimisht arsyetimin dhe pasta ka prezantuar edhe propozimet që kanë ardhur nga Programet buxhetore sipas dokumentit të prezantuar.

Ajo, veç tjerash, bëri të ditur se është marrë pëlqimi nga Ministria për nenet e caktuara kurse sa I përket ndryshimeve ajo tha se ndryshon vetëm data nga viti 2020 në 2021. Për Sektorin e Kadastrit tha se ka ndryshime në harmoni me Udhëzimet e Ministrisë së Ambientit dhe planifikimit Hapësinor. Pastaj prezantoi ndryshimet te neni 6.

z.Naim Zejna; Unë konsideroj se Kuvendi mund ta ndryshojë krejtësisht Rregulloren prandaj duhet të shkojë në diskutim public.

z.Ruzhdi Jashari; Kur flasim për taksat dhe ka implikim të Ligjeve atëherë dokumenti duhet të shkojë në diskutim public. Kjo tregon performanceën positive të Kuvendit..

z.Naim Zejna; Çdo Rregullore që ka implikim buxhetor duhet të na vie para miratimit të buxhetit.

z.Perparim Ramusaj; Rregulloren e aprovojmë çdo vit. Nuk po shoh shumë ndryshime. Propozoj të mos dalë në diskutim public pasi që duhet të fillojë së zbatuarai në vitin 2021.

znj.Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare; Udhëzimi Administrativ na obligon ta zbatojmë këtë Rregullore nga fillimi I vitit dhe nuk ka ndryshime esenciale.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota “Për” me 2 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”, vendosi t’i rekomandoj Kuvendit aprovimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft-Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2021.**

Pika 2

Draft-Kodi Etik i Komunës së Shtimes

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Shala.

z.Bersnik Shala, zyrtar i personelit; Për Draft-Kodin e Etikës sqarime ka dhënë z. Besnik Shala, i cili fillimisht njoftoi KPF-në për formimin e komisionit për hartimin e dokumentit.

Në vazhdim ka sqaruar ligjshmërinë e këtij Drafti dhe obligimet që ka komuna për nxjerrjen e Kodit të etikës.

z.Ruzhdi Jashari; Është e domosdoshme që edhe komunat edhe korporatat private të kenë Kodin e Etikës. Janë rregulla që duhet të zbatohen nga çdo institucion.

z.Bersnik Shala, zyrtar i personelit; Komisioni ka punuar dhe ka mbajtur disa takime me ç’rast kemi arritur që ta definojmë si Draft, i cili, para se të aprovohet, mund të plotësohet dhe të ndryshohet nëse konstatohet se është e domosdoshme.

z.Naim Zejna; Ky Draft e begaton punën e institucionit. Pajtohem që ta nxjerrim në diskutim public.

z.Perparim Ramusaj; Pajtohem plotësisht se është i domosdoshëm Kodi i Etikës ashtu si është propozuar nga Komisioni, prandaj edhe unë konsideroj se duhet ta nxjerrim në diskutim publik.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t’i rekomandoj Kuvendit aprovimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft-Kodin Etik të Komunës së Shtimes.**

Pika 3

Draft-Plani Lokal i Veprimit për Mjedis 2021-2025 për komunën e Shtimes

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Hamëz Tërshani.

z.Hamëz Tërshani, drejtor i DSHP; Drejtori z.Hamzë Tërshani, ka elaboruar **Draft Planin Lokal të Veprimit** për Mjedis 2021-2025, për komunën e Shtimes dhe ka njoftuar KPF-në për hapat që janë ndërmarrë, përms punëtorive të zhvilluara, deri në hartimin e këtij Plani.

z.Naim Zejna; Lidhur me përbërjen e kipit për hartimin e Planit, paraqiti vërejtjen duke thënë se nuk sheh ekspertë të fushës përkatëse. Do të ishte më produktive nëse përbërja do të kishte ekspertë, u shpreh aid he propozoi që ky Plan të nxirret në diskutim publik.

z.Perparim Ramusaj; Gjithashtu ka propozuar që Draft-Plani Lokal i Veprimit për Mjedis 2021-2025, për komunën e Shtimes, të dalë në diskutim publik.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i rekomandoj Kuvendit aprovimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft-Planin Lokal të Veprimit për Mjedis 2021-2025 për komunën e Shtimes.**

Pika 4

Propozim-Ndryshimet në Rregulloren e Punës së Kuvendit, Npi-01/114 dt.26.04.2019

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Te kjo pike, Kryesuesja e KPF-së, znj.Medina Braha, ka njoftuar dhe ka dhënë sqarime lidhur me punën e Komisionit për hartimin e Propozim-Ndryshimeve në Rregulloren e Punës së Kuvendit, Npi-01/114, datë 26.04.2019. Ajo ka paraqitur edhe ndryshimet e propozuara sipas pikave në Ekstrakt-Procesverbalin e Komisionit dhe pastaj ka hapur diskutimin për këtë.

z.Naim Zejna; Propozoj që në Rregullore të bëhen këto ndryshime:

3.5. Kuvendi, Komitetet dhe Trupat tjerë të Kuvendit mund të organizojnë mbledhje nga distanca (on-line) në kushte të veçanta.

3.6. Një ose më shumë anëtarë të Kuvendit për shkaqe të arsyeshme personale mund të kërkojnë që të marrin pjesë në mbledhje të Kuvendit dhe trupave të tij nga distanca (on-line) dhe kjo duhet t'u mundësohet nga Kryesuesi-ja dhe Sekretaria e Kuvendit. Pikat tjera zhvendosen sipas rendit.....

4.1. Pjesëtarëve të publikut që marrin pjesë në mbledhje duhet t'u kërkohej paraqitja e rastit-rasteve të konfliktit të interesit dhe nëse ka, nuk duhet lejuar të marrin pjesë në mbledhje kur shqyrtohet rasti i tyre.

5.2. Një e treta (1/3) e anëtarëve të Kuvendit, me nënshkrimin e tyre mund të fusin një pikë të re në rend të ditës të mbledhjes vijuese të Kuvendit dhe trupave punues të tij, duke paraqitur atë së paku 10 (dhjetë) ditë para mbledhjes së Kuvendit dhe trupave punues të tij te Kryesuesi-ja ose te Sekretaria e Kuvendit.'

z.Ruzhdi Jashari; Neni 6 duhet të përputhet me nenin 47 të ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Konflikti i interesit nuk duhet të përzihet në këtë Rregullore sepse ka natyrë tjetër. Duhet zhvilluar aktivitetet nga Kuvendi për të zbatuar ligjet. Kjo ndikon në performancën e punës së Kuvendit.

z.Perparim Ramusaj; Rregullorja nuk është e pa qartë dhe diskriminuese. Ne si delegate e kemi të drejtën e propozimit të pikave për rend dite. Fillimisht duhet të votohen pikat e rendit të ditës që na propozohen dhe pastaj kemi mundësinë e votimit, "për" ose "kundër".

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Në punën e Komisionit i kam dhënë rendësi nenit 6 (6.2)

znj.Zarife Rexhaj; Propozoj që pika 6.16 të kalojë te pika 6.17. Pandemia na ka kushtëzuar mbajtjen e mbledhjeve on-line prandaj mbështes propozimin e z. Naim Zejna.

z.Naim Zejna; Unë nuk e anashkaloj nenin 47. Propozoj që parashtrimi I pikes me automatizëm të futet në rend dite. Kjo nuk është në kundërshtim me ligjin.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Drejtoni kërkesat për rend dite dhe ato do të merren parasysh. Shfrytëzoni këtë mundësi para mbledhjes dhe pastaj në mbledhje e shqyrtojmë dhe vendosim a do ta përfshijmë në rend dite.

z.Perparim Ramusaj; Kur 1/3 e këshilltarëve propozojnë pikat e rendit të ditës, nuk do të thotë se me automatizëm ato hyjnë në rend dite për shqyrtim. Nuk mund 1/3 e këshilltarëve të na diktojë obligativisht rendin e ditës. Mund të propozohet, por duhet të votohet nga Kuvendi.

z.Ruzhdi Jashari; Problemet që po i ngrisim janë material për pika të veçanta të rendit të ditës. Nuk duhet kërkuar specifikisht të dërgojmë propozimet me imeil.

z.Naim Zejna; E kuptoj vullnetin për t'ju shkruar lidhur me propozimet për rend dite. Unë propozova të bëhet normë propozimi i pikave dhe kjo të përfshihet në Rregullore.

znj.Adelina Beqa; Në Komision ka pasur përfaqësues të subjekteve politike. Propozoj të votohet.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i rekomandoj Kuvendit aprovimin e Ndryshimeve në Rregulloren e Punës së Kuvendit, Npi-01/114 dt.26.04.2019, sipas**

rekomandimeve të Komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2021, dhe ndryshimin e rregullores së punës së Kuvendit, Npi – 01/114, si vijon:

- Neni 6.2 i rregullores mbetet i njëjtë, por të shtohet neni i ri 6.3 që ka të bëjë me nenin 47.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si vijon “ 6.3 Anëtari i kuvendit të komunës mund të kërkojë shtimin e një pikë në rendin e ditës gjatë seancës së rregullt të kuvendit të komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike “.
- 3.5. Kuvendi, Komitetet dhe Trupat tjerë të Kuvendit mund të organizojnë mbledhje nga distanca (on-line) në kushte të veçanta.
- 3.6. Një ose më shumë anëtarë të Kuvendit për shkaqe të arsyeshme personale mund të kërkojnë që të marrin pjesë në mbledhje të Kuvendit dhe trupave të tij nga distanca (on-line) dhe kjo duhet t’u mundësohet nga Kryesuesi-ja dhe Sekretaria e Kuvendit.
- 4.1. Pjesëtarëve të publikut që marrin pjesë në mbledhje duhet t’u kërkojë paraqitja e rastit-rasteve të konfliktit të interesit dhe nëse ka, nuk duhet lejuar të marrin pjesë në mbledhje kur shqyrtohet rasti i tyre.
- 8. Pjesa që ka të bëjë me mirësjelljen e anëtarëve të kuvendit dhe trupave punuese të tij duhet të harmonizohet me Kodin Etik Komunal.

Pika 5

Draft-Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2021

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Kryesuesja e KPF-së, znj.Medina Braha, e ka prezantuar këtë pike, duke dhënë sqarime. Në vazhdim hapi diskutimin.

z.Naim Zejna; Shenimi i përvjetorit të Masakrës së Reçakut të precizohet dhe të dihet saktë çka do të bëjë Kuvendi. Muaji dhjetor është koha kur po hyjmë në zgjedhje prandaj paraqet edhe problem për realizimin e asaj çka planifikohet.

znj.Adelina Beqaj; Propozimet e paraqitura duhet të aprovohen nga Kuvendi.

z.Ruzhdi Jashari; Për datën 15 janar është obligative mbajtja e Mbledhjes Përkujtimore kurse më 12 Qershor dhe 26 Korrik është obligative që Kuvendi të mbajë Mbledhje Solemne.

z.Perparim Ramusa; Propozimet e Ruzhdiut t’i propozohen edhe Kuvendit në mënyrë që të planifikohen, nëse merret vendim për këtë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t’i rekomandoj Kuvendit aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit për Vitin 2021, me rekomandimin si vijon: “ Që Kuvendi të mbajë mbledhjet solemne dhe përkujtimore dhe ato të përfshihen në Planin e Punës siq janë: (15 Janari-Dita e Përkujtimit të Masakrës së Reçakut), (26 Korriku Dita e Dëshmorëve të Komunës së Shtimes) dhe (12 Qershori Dita e Çlirimit të Komunës).**

Pika 6

Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të Kuvendit dhe KPF-së për 2021

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Ka prezantuar këtë pike, duke dhënë sqarime. Në vazhdim hapi diskutimin.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t’i rekomandoj Kuvendit aprovimin e Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të Kuvendit dhe KPF-së për 2021.**

Pika 7

Formimi i tri Komisioneve Vlerësuese për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Ka prezantuar këtë pike, duke dhënë sqarime se Komisionet do të kenë nga 5 anëtarë. Në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.


znj. Adelina Beqa; Propozoj që Kuvendi të propozojë anëtarët e Komisioneve dhe numrin për secilin.

z. Ruzhdi Jashari; A është harmonizuar rregullorja e Gushtit me kriteret për formimin e Komisioneve.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i rekomandoj Kuvendit që të formojë këto Komisione sipas propozimeve që do të dalin në Kuvend.**

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj: Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesja, mbledhjen e përfundoi në ora 11.40h.

Procesmbajtësi:
Ibrahim Demiri



Kryesuesja e KPF
Medina Brahaj

